

**THE LANGUAGE AND THE TRANSLATION – PRESERVING THE  
ESSENTIAL ELEMENT  
GJUHA DHE PËRKTHIMI – RUAJTJA E ELEMENTIT THELBËSOR**

**Adelina XHAFERI<sup>1</sup>**

<sup>1</sup> Department of Albanian Language and Literature, Faculty of Philology, University of Tetova

\*Corresponding author e-mail: adelina.xhaferi@unite.edu.mk

---

**Përmbledhja:** Punimi në fjalë, do të tregojë se sa e rëndësishme është gjuha jo vetëm si sistem rregullash dhe element themelor në komunikimin njerëzor, por, edhe se sa e rëndësishme është vetë mënyra se si ka ecur shoqëria njerëzore, për të arritur deri në ditët e sotme. Ky element, ashtu siç do të shihet në punim, edhe kur bëhet pjesë e përkthimeve të ndryshme duhet ta ruajë thelbin e tij dhe çdo pikë tjetër që nuk duhet të ndryshohet. Sepse, ashtu siç do të flitet në punim, që gjuha ta merrte formën e sotme dhe të krijonte për vete një pasqyrë të drejtë, i duhej kohë e gjatë. Andaj asaj, edhe kur t'i përktheheshin fjalët, të njëjtat duhej të shiheshin që të mos e humbin thelbin e tyre.

**Fjalët kyçe:** shoqëria njerëzore, gjuha, folësit, shqipja, përkthimi.

**Abstract:** The work, itself, will show us how important language is not only as a system of rules or fundamental elements in human communications, but also how important is the way how the society has progressed, to reach the present day. This element, as it will be seen in the work /in the paper, even when it becomes part of the different translations, it must preserve its essence and every another point that must not be changed. Therefore, as it will be discussed in the paper, it took a long time for the language to take its present form and to create a proper image itself. But, on the other hand even when the words were translated, they had to be seen so as not to lose their essence and meaning.

**Key words:** Human society, language, speakers, Albanian language, translation.

---

*“Gjuha, s’ka dyshim, është një nga veçoritë më të rëndësishme të njeriut.”<sup>1</sup>*

Mënyra se si shoqëria njerëzore u përafua hap pas hapi deri tek ajo që quhet gjuhë, e që sot shihet se del element i patjetërsueshëm dhe thelbësor në komunikimin e saj, është histori më vete. E njëjta, e ndjekur nga ndryshimet e vazhdueshme të vëna në përdorim nga nevoja për ta arritur nivelin më të lartë dhe më të kapshëm për folësit e saj, arriti që ndër shekuj ta dëshmonte se, edhe pse e ndërtuar nga fjalë të natyrave të ndryshme, ajo sërish ruajti një pasqyrim të vetin.

---

<sup>1</sup> Sami Frashëri, (2002), Gjuha, Logos-A, Shkup, f. 16.

Në këtë të fundit, duke e parë edhe vetë natyrën e gjuhës sonë, shihet se në të nuk janë të pranishme vetëm fjalët që para folësve dalin me një kuptim të vetëm dhe me formë të ngurtësuar, por, edhe shumë fjalë të cilat, përveç kuptimit parësor, kanë edhe kuptime dytësore e forma të shumta, të cilat dalin varësisht asaj se si përdoren në kohë të folësve. E njëjta gjë është dëshmuar edhe nga autori, i cili ndër të tjera tha se, njëri nga tiparet më dalluese të njeriut është komunikimi me anë të gjuhës dhe të folurit, si një veprim në funksion të njohjes së botës në të cilën jeton dhe si komunikim i ndërjegjeshëm në sferën e vetërealizimit.<sup>2</sup>

Sa herë që flitet për këtë komunikim dhe për këtë arritje të vetë qenies njerëzore, nuk mund të lihet anash pa u përmendur edhe çdo element ndihmues që futet në të, sepse, ky komunikim nuk ka të bëjë vetëm me nxjerrjen e tingujve dhe dallimin e njeriut nga qeniet tjera me frymë mbi tokë, por, edhe me shumë funksione të tjera, të cilat atë, duke i realizuar të njëjtat, e vënë një hap përpara. Të njëjtën gjë e ka pohuar me kohë edhe autori, i cili ndër të tjera, theksoi se: *“Të folurit nuk është gjë e përbërë vetëm nga shqiptimi i atyre zërave, e madje, as nga shqiptimi i atyre fjalëve të plota e të përsosura. Të folurit do të thotë, të shprehësh qëllimin dhe të kuptosh qëllimin, që shprehet me fjalë dhe fjali, të formuara me zëra të artikuluar a fonema.”*<sup>3</sup>

Është diskutuar me kohë se si njeriu ka arritur që ta krijojë gjuhën dhe si të njëjtën bëri që ta paraqiste element kryesor për funksionimin e tij në rrethin në të cilin vepron. Dhe, duke u mbështetur në vetë këtë çështje, studiuesit dhe hulumtuesit e kësaj të kaluarë njerëzore mendjen e çojnë edhe tek ajo se si ka funksionuar vetë shoqëria primitive, sepse e njëjta, edhe pse e ndarë në fise të ndryshme, me të gjitha karakteristikat e saj, u mundua që të krijonte një sistem me rregulla të njëjta për të gjithë. Kjo gjë është thënë edhe nga autori, i cili ndër të tjera pohoi se: *“Fakti që edhe gjuhët e fiseve primitive kanë sistem gramatikor dhe begati të shprehjes, është dëshmi se gjuhët nuk krijohen nga projekte të gjuhëtarëve, por ato janë të dhëna në formën initiale dhe funksionojnë si të tilla për nevojat elementare të folësve, ndërsa pasurimi i mëtejshëm i tyre bëhet në kuadër të zhvillimit të shoqërisë dhe të kulturës.”*<sup>4</sup>

Kjo gjë, e ndërthurur edhe me gjendjen e tanishme të gjuhës, tregon se ajo, si element themelor dhe me një sistem të caktuar rregullash, zhvillohet që të arrihet një komunikim sa më i denjë dhe sa më i drejtë ndërmjet vetë folësve të saj. Këta të fundit, duke u mbështetur edhe në atë se si veprojnë dhe se si vihen në funksion të saj, atë, jo vetëm që e flasin brendapërbrenda hapësirave krijuese dhe vepruese, por, e shohin edhe të dhënë të përkthyer për hapësirat e folësve të tjerë.

Këta të fundit, ashtu siç edhe tashmë dihet, janë folës që identifikohen jo vetëm me territore të ndryshme, në të cilat veprojnë dhe i zhvillojnë aktivitetet e tyre, ose me moshë e profesion të caktuar, varësisht nga ajo se sa kanë arritur të zhvillohen e të ndihmojnë në pasqyrimin e saj, por, edhe me vetë karakteristikat gjuhësore të krijuara ndër vite. Sepse siç ka pohuar dhe autori, dallimet që shtrihen në gjuhë janë jo vetëm territoriale, por edhe sociale e profesionale.<sup>5</sup> Në këtë rast, edhe për vetë natyrën e punimit, vlen të përmendet edhe fakti se, përafrimi a dallimi mes folësve shumë lehtë mund të bëhet edhe në bazë të asaj se ç’gjuhë flasin dhe si e kanë zhvilluar të njëjtën, por, edhe në bazë të asaj se kush ka ndikuar që ajo ta merrte një natyrë të tillë. E në këtë të fundit, ashtu siç është pohuar me kohë, kanë ndikuar jo vetëm faktorët e jashtëm, të cilët e kanë nxitur atë, por, edhe vetë zhvillimi i njeriut, sepse: *“Gjuha lidhet me përparimin mendor.”*<sup>6</sup>

<sup>2</sup> Milazim Krasniqi, (2010), Letërsia dhe besimet fetare, Logos-A, Shkup, f. 17.

<sup>3</sup> Sami Frashëri, (2002), Gjuha, Logos-A, Shkup, f. 39.

<sup>4</sup> Milazim Krasniqi, (2010), Letërsia dhe besimet fetare, Logos-A, Shkup, f. 19.

<sup>5</sup> Rami Memushaj, (2005), Shqipja standarde - Si ta flasim dhe ta shkruajmë, BOTIMET TOENA, Tiranë, f. 45.

<sup>6</sup> Sami Frashëri, (2002), Gjuha, Logos-A, Shkup, f. 44.

Autori, në një vepër të tij studimore e me theks të veçantë te gjuha, si dhe te paraqitja e rrjedha e saj në shekuj të ndryshëm për të arritur deri në ditët tona, ka thënë se: *“Duke u mbështetur në disa vlera të njohura e të ditura, nuk është vështirë që një gjë që nuk dihet e që nuk njihet, ta sjellësh në një gjendje që të njihet.”*<sup>7</sup> Vetë ky pohim, në kuadër të asaj që ngërthejnë studimet e ndryshme, çon të mendohet se pavarësisht asaj se si është gjuha sot dhe se çfarë sistemi ka e njëjta, ajo, sërish, në të djeshmen e saj ka pasur një rrugëtim të bërë hap pas hapi. Ky i fundit, duke u nisur edhe nga fakti se ngërthen brenda vetes rregulla të veçanta e të futura në mendësinë e popullit, të njëjtat edhe sot e kësaj dite i paraqet të domosdoshme edhe në përkthim.

Historia e krijimit të gjuhëve dhe futja e tyre në familje të veçanta gjuhësore për aq kohë sa edhe i përmbushnin kërkesat e së njëjtave, bën që ato të shihen, jo vetëm në raport me veten dhe me ndryshimet që pësonin (si: futjen e fjalëve të reja, ruajtjen e fjalëve burimore, ndryshimin e formave të tyre varësisht folësit dhe rrethanave tjera karakterizuese, apo zëvendësimin e fjalëve të vjetra e të dala nga përdorimi, me fjalë të reja), por, edhe në raport me çdo gjuhë tjetër. Ky raport, që në të njëjtën kohë, përveç faktit që lejonte të shiheshin pikat përafruese të gjuhëve që viheshin përballë njëra-tjetrës, ndihmonte që të shiheshin se sa pika dalluese kishin të njëjtat. Por, duhet ditur edhe ajo se, kjo gjë, për asnjërën gjuhë nuk bëhet në formë të njëjtë. Të njëjtën gjë e jep edhe autori, i cili, ndër të tjera thekson se: *“Duke qenë se gjuha flitet në një hapësirë të gjerë, ndryshimi i natyrshëm që shfaqet me kalimin e kohës, nuk mund të bëhet në forma dhe mënyra të njëjta në çdo anë. Meqë gjuha shfaqet në forma dhe mënyra të ndryshme, së pari ajo degëzohet në disa degë që do t’i ngjajnë njëra-tjetrës dhe, duke e mësuar njërën, do të mund të kuptohen edhe të tjerat.”*<sup>8</sup>

Gjuha, e zhvilluar në vijë të njëjtë me vetë zhvillimin e shoqërisë njerëzore, jo vetëm për nga paraqitja fizike, por, edhe për nga intelektin, ana e saj mendore, arriti që në thelb, ta ruante elementin e vjetër dhe të njëjtin, edhe kur do të duhej ta paraqiste në një gjuhë tjetër, ta jepte me natyrë të thellë dhe të kuptueshme në atë që shprehte. Kjo e fundit, ashtu siç edhe është vepruar deri më sot, do të ishte në interes të madh studimi e njohjeje. Sepse, një fjalë e një gjuhe që mund të përkthehet edhe në një gjuhë tjetër, do të ndihmonte jo vetëm në përvetësimin e saj dhe në mënyrën se si të sillej më mirë një paraqitje e tillë për të tjerët, por, edhe në atë se sa e njëjta, me të gjitha elementet e saj, do të bartte me vete po atë kuptim dhe vlerë të veten. Me këtë rast ajo do të dëshmonte edhe për vetë përsosjen e saj të fituar ndër shekuj.

Kjo e fundit duhet besuar jo vetëm duke u mbështetur në atë se si kjo gjuhë e natyrës së sotme ka sistem rregullash dhe arrin të bëhet e kapshme edhe për të tjerët falë një përkthimi, por, edhe për vetë ecurinë e së njëjtës. Sepse: *“Të besosh se gjuha ka qenë kështu e përsosur, që kur është shfaqur për herë të parë, se të parët tanë që kanë filluar të flasin më së pari, i kanë përdorur me qindra e mijëra vjet pjesët e fjalës dhe të gjitha format e tjera të saj, se kanë mundur të flasin fjalë të lidhura dhe të sistemuara në këtë mënyrë, është sikur të përpiqesh që nga barku i nënës të lindësh njeri të përgatitur si: shkencëtar, dijetar, artist.”*<sup>9</sup>

Andaj, mënyra se si gjuhët arritën që deri në ditët e sotme ta ruajnë thelbin e tyre nga çdo transferim apo ndryshim rrënjësor, lidhet jo vetëm me bindjen që shoqëria duhet ta ruajë të njëjtën pavarësisht se si do të dukej në anën tjetër, por, edhe atë se si do të përshtatej me elementin e huaj, dhe sa me të njëjtin do të vihej në raport përafrues. Ky raport që për syrin dhe njeriun e sotëm, sot, mund të duket mjaft i lehtë dhe i një rruge pa vështirësi, në rrjedhë të viteve i është dashur kohë që të arrihej, sidomos kur ndihej nevoja që tingujt e ndryshëm të natyrës të artikuloreshin më drejt e të ndihmonin në zbulimin e fjalëve normale. Sepse, ashtu siç është paraqitur ana më e mirë në pasqyrimet të jashtme të njeriut dhe shoqërisë në përgjithësi, duhej që i tillë të ishte edhe vetë pasqyrimi i brendshëm gjuhësor i shoqërisë.

<sup>7</sup> Po aty, f. 43.

<sup>8</sup> Sami Frashëri, (2002), Gjuha, Logos-A, Shkup, f. 71.

<sup>9</sup> Po aty, f. 55.

Me këtë rast, edhe për vetë natyrën e punimit vlen të përmendet se: *“Njeriu nuk ka imituar dhe nuk imiton vetëm zërat, lëvizjet dhe veprimet e kafshëve dhe të gjësendeve të tjera. Ai madje ka imituar dhe imiton edhe vetë gjendjet dhe lëvizjet e tyre dhe, sidomos, bërtimat dhe thirrjet e tyre, prej të cilave janë sajuar, përkatësisht kanë lindur shumë fjalë të reja, sepse njeriu kur është shfaqur për herë të parë, sado që nuk ka qenë i aftë të flasë, ai që në zanafillë ka qenë i aftë të riprodhojë a të nxjerrë thirrje, bërtimë a tinguj, sepse këtë ia ka mundur gjendja e tij e natyrshme.”*<sup>10</sup> [sic!]

Duke e pasur të njohur faktin se gjuha njerëzore, me theks të veçantë, shqipja, ka pësuar ndryshime të vazhdueshme me synimin që ta merrte formën më të plotë dhe të karakterizohej me fjalë të drejta për përdorim, duhet pranuar dhe fakti që, të tillat duhet ta ruajnë atë formë edhe kur përkthehen. Kjo rregull, ashtu siç është pranuar dhe respektuar ndër vite dhe për aq kohë sa shoqëria e paraqiti si të tillë, duhet të ruhet edhe në të ardhmen. Këtë duhet ta bëjnë jo njerëzit të cilët mëtojnë për një përkthim sa për sy e faqe, ose, sa për të thënë se mund të hyjnë në rrugën e përkthimit, por, njerëzit që atë, përveçse profesion e kanë dhe pasion. Sepse, jo më larg se ajo që është menduar me kohë, shoqëria jonë nuk do t’i ngjante kësaj po të mbetej vetëm me të veten. Andaj, njeriu, ashtu siç u zhvillua vetë, ashtu siç e bëri edhe gjuhën mjet të domosdoshëm komunikimi, ashtu duhej që të njëjtën ta paraqiste edhe në nivel përkthimi.

Me anë të përkthimit dhe mënyrës se si njerëz të caktuar merren me të, shoqëria njerëzore, si në të kaluarën, ashtu edhe në ditët e sotme, nuk do të njihej vetëm me atë se në ç’nivel paraqiteshin gjuhët brendapërbrenda saj, por, edhe për atë se sa do të mësohej për kulturat tjera. Këto të fundit, duhet ditur se sa do të vlerësoheshin nga e huaja, falë një përkthimi të drejtë. E huaja, duke u nisur nga vetë bindja se për një pasqyrim sa më të drejt të gjuhës dhe të sistemit të saj të mbushur me rregulla, mbetet e tillë vetëm si term. Sot e kësaj dite ajo nuk duhet parë me sy të tillë, sepse, për aq kohë sa jepet në formë të drejt dhe para lexuesve përkthimi është në nivel edhe për nga respektimi i rregullave gjuhësore, duhet të shihet si mundësi përafrimi e njohje të kulturave të ndryshme.

Gjatë përkthimit, ashtu siç edhe tashmë është vërtetuar në një numër të madh të veprave letrare e studimore të autorëve vendas, kombëtarë ose të të huajve, dëshmohet se njerëzit që merren me të, nuk shohin vetëm atë se si ta sjellin në gjuhën e tyre fjalën, apo, se si të njëjtën duan ta bëjnë të afërt për tjetrin, por, edhe me atë se sa për të i respektojnë rregullat gramatikore (përfshirë në këtë rast vetë morfologjinë dhe sintaksën e një gjuhe). Sepse, pa to, përkthimi, jo vetëm që do të dilte i paplotësuar, por, në të njëjtën kohë, në asnjë mënyrë nuk do ta tregonte as edhe natyrën e plotë, të cilën një gjuhë mundohet ta krijojë në rrjedhë kohe.

### **Literatura e shfrytëzuar:**

[1] Frashëri, S., (2002), Gjuha, Logos-A, Shkup;

[2] Memushaj, R., (2005), Shqipja standarde - Si ta flasim dhe ta shkruajmë, BOTIMET TOENA, Tiranë;

[3] Krasniqi, M., (2010), Letërsia dhe besimet fetare, Logos-A, Shkup.

---

<sup>10</sup> Sami Frashëri, (2002), Gjuha, Logos-A, Shkup, f. 51.